



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 300/5 prot.

Tiranë, më 30.7.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 778, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 15.7.2024, është njoftuar vendimi nr. 778, datë 28.6.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 778, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu, aktualisht ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3,

të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Vjollca Spahiu”² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit Raportin nr. *** prot., datë **.11.2017, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, dhe ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Vjollca *** Spahiu”³. Pas kërkesës së Komisionit për përditësim, AKSIK ka përcjellë Raportin nr. ***, datë **.11.2023⁴, ku ka referuar se: [...] *nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Vjollca *** Spahiu [...].*

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁵ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Vjollca Spahiu.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë:** [...] *bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.4.2018.

³ Sqarojmë se ky raport është përpiluar pa përgjigjen e një prej tri organeve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ Shtetëror.

⁴ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë **.11.2023, të KDZH-së.

⁵ Raport i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***/* prot., datë **.7.2021.

të rivlerësimit, ky i fundit ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e saj nga detyra. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. [...].⁶

3.2 Për kontrollin e figurës: [...] nuk verifikohet asnjë nga elementet për të ngritur dyshime për papërshtatshmëri në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit, konform parashikimeve të neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016 [...].⁷

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale: [...] Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim i të drejtave të palëve apo mangësi në arsyetimin e vendimeve të dhëna prej saj. Në këto kushte, znj. Vjollca Spahiu vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues [...].⁸

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit.

9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 778/2024, të Komisionit, dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të

⁶ Referohuni në faqen 37, prg. 177, të vendimit të Komisionit.

⁷ Për më tepër, referohuni në faqen 42, prg. 208, të vendimit të Komisionit.

⁸ Për më tepër referohuni në faqen 54, prg. 285, të vendimit të Komisionit.

nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

10. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 778, datë 28.6.2024, të Komisionit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A - Kontrolli i pasurisë

11. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

12. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

13. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe asaj "Vetting", dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në datën **.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

14. Njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m², ndodhur në rrugën "**** **", Tiranë

14.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Dyqan me sipërfaqe 53 m², e blerë sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., datë **.3.2005, me firmën "****". Aktualisht është i pahirpotekuar. Burimi i krijimit: Kredia e marrë në ***, në vlerën 40.000 euro, sipas kontratës së kredisë bankare nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.06.2005, dhe pjesa tjetër 23.600 euro, krijuar nga kursimet familjare ndër vite dhe kreditë konsumatore pranë *** Bank. Vlera 63.600 euro. Pjesa takuese 50%.*

14.2 Në DV-2005, të administruar në dosje të Komisionit, përcjellë nga ILDKPKI, rezultojnë dy faqe të numëtuara me nr. 3, "*Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme*". Në njëërën prej këtyre faqeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm lidhur me likuiditetet *cash*, ndërsa në faqen tjetër të numëtuar po me nr. 3, e cila duket se është dërguar me *fax*, dhe ka këto shënime: "*Për znj. ***, ***, **/11/2013 19:01 FAX ****", subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "*Prenotuar dyqan me sipërfaqe 53 m², sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë **.3.2005. E krijuar në bazë të kredisë së marrë në vlerën 40.000 euro nga ***. Detyrimi i shlyerjes bëhet me 3 këste, paguar kësti sipas kredisë, mbetur pjesa e detyrimit pas regjistrimit të objektit në ZVRPP. Vlera 63.600 euro*".

14.3 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *Shlyerja e plotë e kredisë së mbetur pranë ***, datë **.10.2007. Shlyerja e bërë sipas aktit noterial nr. *** rep., dhe nr. *** kol., i publikuar tek të dhënat konfidenciale dhe gjendjes cash në banesë. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të së njëjtës deklarate, subjekti ka deklaruar: Marrje hua në shumën 3.000.000 lekë tek *** *** për shlyerjen e kredisë në ***, sipas aktit noterial nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.10.2007.*

14.4 Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shlyerje e plotë e detyrimit “****” sh.p.k., me mandat arkëtimi datë **.6.2010. Vlera 23.600 euro. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

14.5 ASHK, Tirana Jug, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.5.2023, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, ka përcjellë këto akte:

(1) Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., datë **.3.2005, me palë investitore shoqërinë “****” sh.p.k., dhe palë porositëse z. *** ***, me objekt ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m² në rr. “**** **”, Tiranë, lidhur pranë noterës publike ***. ***, Tiranë. Sipas kontratës, çmimi për metër katror është 1.200 euro/m² dhe pagesa do të kryhej në tri këste, e konkretisht: a) kësti i parë është paguar me nënshkrimin e kontratës në shumën 20.000 euro; b) kësti i dytë do të paguhet pas 5 muajve, në shumën 30.000 euro; dhe c) kësti i tretë, prej 10.000 euro, do të paguhet me mbarimin e objektit të ndërtimit.

(2) Kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.9.2020, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse *** dhe Vjollca Spahiu, për objektin Njësi me sip. 55.11 m², me nr. pasurie */***-**, lidhur pranë noterës publike ***. ***, Tiranë. Në kontratë citohet se *shitësi deklaron se i ka shitur blerësit Njësinë kundrejt shumës 63.600 euro. Kjo shumë është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë **.3.2005.*

14.6 ***-ja, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.8.2020, ka përcjellë në Komision dokumentacionin e kërkuar, lidhur me kredinë e përfutur nga subjekti dhe personi i lidhur pranë kësaj banke. Bashkëlidhur kësaj shkrese, ndër të tjera, janë administruar:

(1) Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., datë **.5.2005, me palë investitore shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë porositëse z. *** ***, me objekt ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m², lidhur pranë noterës publike ***. ***, Tiranë. Pagesa është 2.500 euro/m² dhe pagesa do të kryhej në tri këste: kësti i parë është paguar me nënshkrimin e kontratës, në shumën 62.000 euro, dhe kësti i tretë do të paguhet me mbarimin e objektit dhe me dhënien e dokumentacionit përkatës⁹.

(2) Kontratë qiraje nr.*** rep. dhe nr. ** kol., datë **.5.2005, me palë qiradhënëse *** dhe Vjollca Spahiu dhe palë qiramarrëse *** ***, me objekt qiradhënien e apartamentit me sip.75 m² (në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur), ndodhur në shëtitoren “**** **”, Tiranë, kundrejt vlerës 60.000 lekë/muaj, lidhur pranë noterit **. ***, Kukës.

14.7 Komisioni, në kushtet kur për të njëjtën pasuri rezultuan dy kontrata sipërmarrje me të dhëna të ndryshme, me shkresën nr.*** prot., datë **.4.2023, iu drejtua noterës ***. ***, për të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin që disponon për aktin Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.5.2005, të lidhur mes shtetasve *** *** dhe investitorit “****”.

⁹ Në këtë kontratë nuk ka parashikime lidhur me këstin e dytë.

Noterja ***, ***, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se nga verifikimi në Regjistrin e veprimeve dhe akteve noteriale, numrat rep. dhe kol., datë, nuk korrespondojnë dhe janë veprime që nuk i përkasin këtyre shtetasve.

14.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, i pyetur nga Komisioni lidhur me sa më sipër, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] nuk është shlyer ndonjëherë pagesë në shumën 62.000 euro, si një shumë e vetme në favor të shoqërisë. Për shkak të politikave të njohura bankare, të cilat përgjithësisht nuk financojnë më tepër sesa 70 % të shumës, krahasuar me pasurinë që vendoset si garanci, detyrimisht kërkohet një rritje e vlerës e pavullnetshme, por me qëllim realizimin e marrjes së kredisë. Për këtë arsye, si opsione të asaj që sugjeron politika bankare është pikërisht gjetja e një kontrate sipas kushteve që dikton banka, me qëllim miratimin e kredisë ... Kontrata që përputh realisht vullnetet e palëve, që është deklaruar rregullisht prej meje, e që ka sjellë edhe pasojat juridike, ka qenë kontrata fillestare e datës **03.2005. Ndërsa kontrata e administruar në bankë ka qenë tipikisht për të siguruar marrjen e kredisë dhe, si e tillë, është përpiluar dhe administruar vetëm në dobi të kësaj procedurë, kjo shpjegon edhe rrethanën që kjo kontratë nuk ka asnjë klauzolë për revokimin e kontratës më të hershme[...].

14.9 Lidhur me kontratën e qirasë të administruar në dosjen e kredisë, në përgjigje të Pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] Arsyeja e vetme e bërjes së kontratës së administruar në praktikën e kredisë, deklarohet se ka qenë përmbushja e orientimit të dhënë nga punonjës të bankës, të cilët, pasi janë njohur me vlerën e qirasë së apartamentit dhe kontratën e bërjes së pasurisë, në shumën 3 mln lekë, nuk mund të miratonin kredinë për blerjen e njësisë/dyqanit, për shkak të politikave shtrënguese në vlerën e dhënies së kredisë, krahasuar me garancinë që duhej dhënë dhe vënë në dispozicion të bankës. Në këto kushte, kontrata ka shërbyer si një garanci bankare që provonte të ardhura më të larta, që do të krijonin besimin se kredia mund të shlyhej. Për të bërë të mundur këtë garanci bankare, i vetmi që mund të më vinte në ndihmë për të realizuar këtë akt (kontratën e qirasë me një vlerë më të lartë) ishte personi im i familjes, xhaxhai, i cili m'u përgjigj dhe ne e finalizuam aktin. Kjo kontratë nuk ka shtrirë efekte në asnjë drejtim, përveçse në përfutimin e kredisë. Deklarohet se xhaxhai im së bashku me familjen e tij nuk kanë jetuar dhe as kanë punuar ndonjëherë në Tiranë, por vijojnë të jetojnë e punojnë në qytetin e Kukësit [...].

14.10 Komisioni ka administruar informacion nga shoqëria “****”¹⁰ sh.p.k., e cila, me shkresën nr. extr. prot., datë **.3.2023, ndër të tjera, ka informuar Komisionin se, mes z. *** dhe shoqërisë “****” sh.p.k., është lidhur kontrata e sipërmarrjes në vitin 2005. Çmimi për pasurinë e paluajtshme ka qenë në një total prej 63.600 euro, që është likuiduar sipas mandatit të arkëtimit nr. *, datë **.6.2005 (arkëtuar në datën **.7.2005, sipas Librit të arkës), të shumës 40.000 euro dhe mandatit të arkëtimit nr.**, datë **.6.2010 (arkëtuar në datën **.6.2010, sipas Librit të arkës), të kështit prej 23.600 euro¹¹.

14.11 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Komisioni, referuar akteve të administruara nga ***-ja, ka konstatuar se nga kredia e disbursuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, është tërhequr cash, në datën **.7.2005, shuma 38.600 euro, ndërkohë që

¹⁰ E cila, referuar ekstraktit historik në QKB, rezulton se ka ndryshuar emrin në “****” sh.p.k.

¹¹ Bashkëlidhur kësaj shkrese, shoqëria ka depozituar Kontratën e porosisë nr. **, datë **.3.2005, Kontratën e shitjes të v. 2020; mandatpagesat e vitit 2005 dhe 2010; fletët e Librit të arkës për arkëtimet e vitit 2005 dhe 2010.

mandatpagesa në shumën 40.000 euro, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, mban datën **.6.2005, disa ditë përpara tërheqjes së kredisë bankare.

14.12 Komisioni ka konstatuar se, në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2005, 2006, 2007, si dhe në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit në Tiranë në vlerën prej 360.000 lekë/vit (pa kontratë qiraje), për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në shumën prej 162.000 lekë, në vitin 2020. Lidhur me këto të ardhura, Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë në analizë financiare, për sa kohë nga subjekti nuk u paraqit dokumentacion ligjor i kohës, që të provonte marrëdhënien e qirasë, për të gjithë periudhën e pretenduar, apo përfitimin real të të ardhurave (për shembull, me transferta bankare apo mandat arkëtimi), por edhe për faktin që pagesa e detyrimeve tatimore nuk është kryer në periudhat përkatëse, por është kryer në vitin 2020.

14.13 Në vijim, Komisioni ka përllogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të likuiduar këstin e parë në datën **.7.2005, nëpërmjet kredisë bankare, duke e konsideruar çmimin e Njesisë së shërbimit në vlerën 63.600 euro (me 1.200 euro/m²), sipas kontratës së depozituar nga subjekti pranë ASHK-së, nga ku subjekti ka rezultuar me balancë pozitive, si dhe nuk ka konstatuar problematika lidhur me pagesën e shumës 23.600 euro, sipas mandatit nr.**, datë **.6.2010.

14.14 Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë në ***, të deklaruar në DV-2007, Komisioni ka konstatuar se huadhënësi, shtetasi **. ***, ***, ka disponuar të ardhura të mjaftueshme për dhënie e huas në vlerën 3.000.000 lekë dhe se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë rezultuar me burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë (me burim nga huaja dhe gjendja *cash*). Ndërsa për zëvendësimin brenda vitit 2007, të gjendjes *cash* të përdorur për likuidimin e kredisë¹², subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën -631.508 lekë.

14.15 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, ndër të tjera, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) *Duket se ka mospërputhje mes datës kur është lëshuar mandati i pagesës së këstit të parë, në shumën prej 40.000 euro (**.6.2005) dhe datës kur janë tërhequr fondet e kredisë të deklaruara si burim për kryerjen e kësaj pagese (**.7.2005); (ii) Duket se përgjatë procedurave të përfitimit të kredisë në fjalë, subjekti ka nënshkruar një kontratë fiktive, me një çmim më të lartë nga çmimi i shitblerjes, që rezultonte në një kontratë të mëhershme; (iii) Duket se, nga tërësia e veprimeve të kryera nga subjekti, për përfitimin e pasurisë Njësi shërbimi, mbetet i paqartë çmimi real i blerjes së pasurisë në fjalë dhe, për pasojë, subjekti mund të gjendet në kushtet e nenit D të aneksit të Kushtetutës.*

14.15.1 Lidhur me shlyerjen e parakohshme të kredisë në ***, Komisioni ka konstatuar se: (i) *Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme nga huaja dhe kursimet e disponuara cash në banesë, të mjaftueshme për likuidimin e parakohshëm të kredisë në ***.* (ii) *Duket se subjekti ka patur mungesë të burimeve financiare për rikrijimin e gjendjes cash deri në **.12.2007, në masën – 631.508 lekë.*

¹² Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 3. lidhur me gjendjen *cash* të vitit 2007, ndër të tjera, ka deklaruar: *Në këtë vit nuk ka pasur ndryshime të gjendjes cash, një pjesë e saj është përdorur për të mbyllur kredinë, por shtesa dhe pakësimi ka qenë pothuajse në të njëjtën vlerë.*

14.16 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime përfundimtare, ndër të tjera, ka deklaruar¹³: [...] Nga ç'ka më ka shpjeguar bashkëshorti në atë kohë, pasi prej tij janë ndjekur procedurat e dhënies së kredisë dhe nënshkruar kontrata e sipërmarrjes, jemi orientuar nga vetë punonjësit e bankës, që të mund të aprovohej kredia prej 40.000 euro, do duhej të prezantonim të ardhura më të larta se ato të paraqitura nga ne fillimisht... Pra, që ne të mund të na aprovohej kredia, do duhej që të kishim një kontratë sipërmarrje me vlerën e objektit të financimit/dyqanit që po blihej, 100.000 euro; të kishim të ardhura më të larta se ato të ofruara prej nesh, për të kompensuar mosmbulimin e kredisë me kolateral sa ç'kërkohej nga banka; ose të sillnim një garantor financiar me të ardhura të larta dhe stabël; si dhe të nënshkruanim si bashkëkredimarrës dhe/ose dorëzanës ... Të gjendur para një situate, e cila ishte pa zgjidhje, me një dakordësi të përfunduar mes bashkëshortit dhe subjektit ndërtues, me një kontratë sipërmarrje të firmosur nga të dyja palët dhe me një nevojë për ta blerë atë dyqan për arsye investimi, na u desh të zgjidhnim rrugën e detyrueshme dhe të plotësonim atë çfarë na kërkonte banka ***, për aprovimin e kredisë. Për këtë arsye, nga ana e bashkëshortit, është dorëzuar një kontratë, e cila ka një vlerë më të madhe sesa ajo që, në fakt, kemi paguar, pra u vendos një vlerë siç e kërkonte banka, që të na siguronte aprovimin e shumës 40.000 euro ... Sidoqoftë, vlerësoj se është e rëndësishme të theksoj se të gjitha këto akte të kërkuara nga banka janë përdorur vetëm në kuadër të përmbushjes së politikave të saj, të cilat, të konsideruara mjaft të ngurta dhe të tepërta edhe nga vetë punonjësit e bankës, orientonin klientët në zgjidhjet sikurse në rastin tonë. Paraqitja e kontratës në fjalë, provohet edhe nga hetimi i Komisionit se është paraqitur vetëm në kuadër të procedurës së kredidhënies, praktikë, e cila rezulton të ndiqet nga shumë kredimarrës, të cilët i drejtohen bankave për të financuar, pjesërisht apo tërësisht, pasuri të tyre. Ndërsa lidhur me analizën financiare të vitit 2007, subjekti ka pretenduar që, në analizën financiare, të përfshihen të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë, si dhe të reduktohen shpenzimet e jetesës së bashkëshortit [...].

14.17 Komisioni, në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se: **(1)** Lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni mes datës së disbursimit të kredisë dhe mandatpagesës së kështit të parë për blerjen e Njësisë, ka çmuar t'i referohet dokumentacionit të paraqitur së bashku me përgjigjen e shoqërisë ndërtuese, nga ku konfirmohet se: "Çmimi për pasurinë e paluajtshme ka qenë në një total prej 63.600 euro, e cila është likuiduar sipas mandatarkëtimit nr. *, datë **.6.2005 (arkëtuar në datën **.7.2005, sipas Librit të arkës) të shumës 40.000 euro dhe mandatarkëtimit nr. **, datë **.6.2010 (arkëtuar në datën **.6.2010, sipas Librit të arkës), të kështit prej 23.600 euro".

14.17.1 **(2)** Lidhur me çmimin e kësaj pasurie: [...] trupi gjykues ka konstatuar se përkojnë vlerat dhe momentet e pagesave të deklaruara e të konfirmuara, si nga subjekti, ashtu edhe nga shoqëria ndërtuese, si dhe modalitetet e kryerjes së pagesave për pasurinë në fjalë, duke u paraqitur në harmoni të plotë deklaratimet dhe veprimet objektive me këtë shoqëri, dhe nga përmbajtja e dokumenteve të administruara nga Komisioni. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron bindës deklaratimin e subjektit lidhur me datat dhe vlerat e pagesave të kryera për blerjen e kësaj pasurie, me çmim 63.600 euro.

14.17.2 **(3)** Lidhur me konstatimin për nënshkrimin e një kontrate fiktive: [...] trupi gjykues çmon të evidentojë dhe mbajë në konsideratë sa vijon: (i) Kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë

¹³ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ, faqe 18-22.

3.2005, me shoqërinë “*” sh.p.k., si dhe kontrata e sipërmarrjes nr. ***/**, datë **5.2005 (me çmimin 2.500 euro/m²) janë nënshkruar vetëm nga bashkëshorti i subjektit; (ii) Referuar kontratës së kredisë bankare nr. ***/**, datë **6.2005, për shumën 40.000 euro, me objekt “Blerje shtëpie”, ka rezultuar se kredimarrës ka qenë bashkëshorti i subjektit, ndërsa subjekti ka qenë dorëzanëse; (iii) Veprimi nuk ka sjellë asnjë pasojë në raport me asnjë subjekt, duke përfshirë këtu edhe interesat privatë të institucionit financiar bankar, qëllimi i paraqitjes së aktit me vlerë të ndryshme/më të lartë pranë ***-së lidhet drejtpërdrejt dhe vetëm me procesin e kreditimit para kësaj të fundit, për t’u përshtatur me politikën e saj. Në këto kushte, përdorimi i aktit me shifra monetare më të larta sesa realiteti, i sugjeruar apo përgatitur nga banka dhe i nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit sipas orientimeve të bankës, nuk ka pasur si qëllim për t’u shmangur nga detyrimi për kthimin e saj, por mundësimin e marrjes. Sikurse ka rezultuar nga hetimi, kredia është përfituar jo në kushte preferenciale, por në kushtet e tregut, për qëllimin e deklaruar dhe kthyer sipas kontratës, duke u paguar e plotë përpara përfundimit të afatit të parashikuar. Në këto kushte, veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit nuk mund të afektojnë vetë subjektin, qoftë edhe në aspektin etik. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë indicie për të qenë përpara dyshimit të nenit D të Kushtetutës, në raport me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, për sa kohë që provohet marrëdhënia juridike me subjektin ndërtues; janë të dokumentuara me akte të kohës veprimet financiare; është konstatuar se çmimi i blerjes ishte shumë më i lartë se ai i referencave të EKB-së dhe është provuar mënyra dhe koha e pagesave me burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të përballuar krijimin e pasurisë, Njësi me sip. 53 m².*

14.17.3 Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e pretenduara arrijnë një vlerë totale prej 1.080.000 lekësh. Në DIPP-të periodike (2005 – 2007) është deklaruar periudha e dhënies së apartamentit me qira, vlera e përfituar, si dhe fakti se kjo marrëdhënie nuk ka qenë e formalizuar përmes një kontrate me shkrim (për shkak të afatit më pak se 1 vit). Marrëdhënia e qirasë është konfirmuar edhe përmes deklaratës së qiramarrësit, e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Po ashtu, referuar vërtetimit nr. *** prot., datë **2.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, konfirmohet pagesa e tatimit në burim në shumën 162.000 lekë, e cila i korrespondon të ardhurave të përfituara prej 1.080.000 lekësh (1.080.000 x 15% = 162.000 lekë). Gjithashtu, sipas konfirmës bankare të lëshuar nga *** mbi detajet e pagesës sqarohet: “162.000 all, tatim burim mbi qira, banesë Tiranë Bly. “**** **”, nd. **, vitet 2005 – 2007”, me përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

14.17.4 Pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit, edhe në këtë rast *mutatis mutandis*, Komisioni ka korrigjuar analizën financiare (ndër të tjera), duke shtuar të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë dhe duke reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë rezultuar me një pamundësi financiare në shumën -209.964 lekë, për vitin 2007.

14.18 Në përfundim, për kriterin e pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *balanca negative në shumën totale prej - 397.547 lekësh shpërndahet në dy vite (2003 dhe 2007), në vlera jodomethënëse, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit ... bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në*

përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e saj nga detyra. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 [...].

14.19 Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë *Njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m²* dhe burimet e krijimit të saj, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa vijon:

14.19.1 Ashtu sikurse ka konstatuar dhe Komisioni, rezulton se gjatë hetimit janë administruar dy kontrata sipërmarrje të lidhura nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), me objekt të njëjtën pasuri, *Njësi shërbimi me sipërfaqe 53 m²*, lidhur mes të njëjtave palë, me data të ndryshme, ekstremitete të ndryshme, vlera të ndryshme, modalitete pagese të ndryshme, pranë të njëjtës zyrë noteriale¹⁴. Po ashtu ka rezultuar e provuar dhe e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, nënshkrimi në cilësinë e qiradhënësve të kontratës së qirasë nr.*** rep. dhe nr. ** kol., datë **.5.2005, me familjarë të saj. Këto akte janë hartuar vetëm në funksion të marrjes së kredisë pranë bankës së nivelit të dytë, në të cilën subjekti është në cilësinë e dorëzantes dhe përfitueses së kredisë.

14.19.2 **Komisioneri Publik**, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, arsyeton se ndryshimi i kushteve themelore të kontratës, vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë dhe jo qëllimit të vetë palëve, përmban elemente të fiktivitetit¹⁵, pasi marrëveshja e palëve kontraktore nuk ka pasur qëllim që të sjellë pasojat juridike të ligjshme. Analiza e fakteve tregon që palët kanë pasur qëllim shmangien e zbatimit të normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare.

14.19.3 Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e pranuar prej vetë subjektit të rivlerësimit, që konsistonin në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara, vetëm në shërbim të përfitimit të kredisë, dhe nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që, ndër të tjera, është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje, të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë.

14.19.4 Subjekti i rivlerësimit, me veprimet e kryera në funksion të përfitimit të kredisë tregtare në vitin 2005, për qëllim përfitimi financiar, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive/të simuluar, të cilat janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një gjyqtar dhe, si pasojë, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit¹⁶, rezulton se ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.19.5 *Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie*, paraprakisht, Komisioneri Publik, bazuar në legjislationin e zbatueshëm, aktet në dosje, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, konstaton se në Kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep./*** kol., datë **.9.2020, e lidhur pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting” dhe fillimit të procesit të

¹⁴ Ndërkohë, noterja ***. ***, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se nga verifikimi në Regjistrin e veprimeve dhe akteve noteriale, numrat rep. *** dhe kol.***, datë **.5.2005, që i përkasin kontratës të depozituar pranë bankës *** sh.p.k., nuk korrespondojnë dhe janë veprime që nuk i përkasin z. *** *** dhe shoqërisë “****” sh.p.k.

¹⁵ Neni 92 i Kodit Civil parashikon: “[...] Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”.

¹⁶ Referohuni, ndër të tjera, qëndrimin të Kolegjit në vendimin (JR) nr. 28/2019.

rivlerësimit, mes subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. ***. ***, me shoqërinë “***” sh.p.k., ndër të tjera, citohet se: *shitësi deklaron se ia ka shitur blerësit Njësinë me të dhënat sa më sipër, kundrejt shumës 63.600 euro. Kjo shumë është likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., datë **.3.2005, ku përcaktohet se: kësti i parë është paguar me nënshkrimin e kontratës në shumën 20.000 euro.*

14.19.6 Komisioneri Publik, vlerësimin e kësaj situate e bën bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit¹⁷, lidhur me faktin se përcaktimi i kohës së shlyerjes së shumave, sipas Kontratës së sipërmarrjes së datës **.3.2005, është një parashikim orientues i palëve për mënyrën e shlyerjes së çmimit për këstet e mbetura pa paguar, duke përjashtuar këstin e parë të paguar me nënshkrimin e kontratës të datës **.3.2005, rrethanë faktike kjo, e konfirmuar dhe me kontratën e shitjes të vitit 2020.

14.19.7 Në këtë drejtim, **Komisioneri Publik** mban në konsideratë qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën e tij të deritanishme¹⁸, në të cilën është mirëpërcaktuar se vlerat e kontratave (për më tepër ato të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme) nuk mund të ndryshohen/kontestohen me akte të prodhuara përgjatë dhe në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Vlerat e përcaktuara në këto akte zyrtare me fuqi të plotë provuese kanë forcën e ligjit për palët.

14.19.8 Në këtë situatë faktike, Komisioneri Publik vlerëson se kontrata e shitblerjes, me forcën e ligjit për palët, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil, përbën provë të plotë të deklarimeve të pavesuara dhe të ligjshme të palëve përpara noterit, në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile¹⁹.

14.19.9 **Komisioneri Publik** vlerëson se përmbajtja e Kontratës noteriale e datës **.3.2005 do të konsiderohet si referim ligjor për sa parashikohet në të, më së paku, për këstin e parë në shumën 20.000 euro, paguar me nënshkrimin e saj. Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e këstit të parë të apartamentit, në shumën 20.000 euro, duke u gjendur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

14.19.10 **Komisioneri Publik**, përveç sa më sipër, vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën, lidhur dhe me pamjaftueshmërinë e konstatuar në vitin 2007, pasi:

(1) Sikundër konstatuar dhe nga Komisioni, tatimet lidhur me të ardhurat e deklaruara nga qiraja e apartamentit në Tiranë janë paguar pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, për efekt të procesit të rivlerësimit dhe, si rezultat, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, këto të ardhura nuk plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, për efekt të këtij procesi.

(2) Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me shumën dhe kohën e të ardhurave/kompensimeve të pretenduara si të përfituara nga bashkëshorti në cilësinë e ushtarakut dhe, në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 duhen llogaritur sipas standardit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, në shumën 235.968 lekë për secilin anëtar të familjes. Si rezultat, duke zbritur nga analiza financiare e Komisionit, të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë dhe duke llogaritur shpenzime jetese në total në

¹⁷ Referohuni vendimit (JR) nr. 20/2019, prg. 40.

¹⁸ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 16/2019 ; (JR) nr. 34/2019; (JR) nr. 9/2020 dhe (JR) nr. 41/2022.

¹⁹ Referohuni vendimit (JR) nr. 6/2024 të Kolegjit.

vlerën 1.179.840 lekë, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me një pamjaftueshmëri financiare për vitin 2007, në vlerën -1.195.905 lekë²⁰.

14.20 Në përfundim, lidhur me sa më sipër, **Komisioneri Publik** vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të “Njësisë së shërbimit me sipërfaqe 53 m,² në Tiranë”, në shumën 20.000 euro, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për vitin 2007, në vlerën 1.195.905 lekë, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

14.20.1 Subjekti i rivlerësimit, me veprimet e kryera në funksion të përfitimit të kredisë tregtare, në vitin 2005, ka kryer veprime juridike fiktive/të simuluar, të cilat janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një gjyqtar dhe, si pasojë, ka cenuar besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15. Apartament me sipërfaqe 75 m², në Tiranë, në vlerën 3.000.000 lekë

15.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. prej 75 m² në Tiranë, blerë në vitin 2003 sipas Kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2003, e hipotekuar sipas certifikatës së vërtetimit të pronësisë nr. ***, datë **.3.2015, pasuria me nr. */***+*-.**, në z. k. ***, me sip. 75 m², Tiranë. Burimi krijimit: nga kursimet familjare ndër vite. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

15.2 Në DV-2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shtëpi banimi me sip. prej 75 m,² ndërtuar në vitin 2000. Adresa: *** ***, Shëtitore ***.***, Tiranë, blerë në vitin 2004. Vlera 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Data e krijimit **/01/2004.*

15.3 Nga aktet në dosje²¹ të Komisionit rezulton se kjo pasuri është përfituar me Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2003, me palë shitëse ***, ***, dhe palë blerëse *** dhe Vjollca Spahiu, me objekt: Shitje apartamenti me sipërfaqe 75 m,² kundrejt vlerës 3.000.000 lekë.

15.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) *Subjekti ka pasaktësi në deklarin e kësaj pasurie, si për sa i përket vitit të deklarin (blerë në 2003, deklaruar në 2004), po ashtu edhe lidhur me burimin e krijimit, i cili nuk është deklaruar në vitin 2004;* (ii) *Në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka patur një mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, në masën – 517.039 lekë;* (iii) *Duket se çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë më i ulët se çmimet e referencës sipas EKB-së, si dhe nga sa e kishte përfituar vetë shitësi rreth 3 vite me parë;* (iv) *Duket se të ardhurat nga qiraja për periudhën 2002 – 2003, në shumën 14.600 USD, të pretenduara nga subjekti, (në këtë fazë), nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk u provua me dokumentacion të kohës marrëdhënia e qirasë apo pagesat e detyrimeve tatimore të tyre.*

15.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka deklaruar²² se: *[...] Sidoqoftë, unë e kam deklaruar apartamentin në fjalë në vitin pasardhës, duke e korrigjuar pasaktësinë e*

²⁰ Gjithashtu, edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit, sërisht do të rezultonte me mungesë burimesh financiare të ligjshme për vitin 2007.

²¹ Shkresa e ASHK-së, Tirana Jug, nr. ***/* prot., datë **.5.2023.

²² Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për rezultatet e hetimit administrativ, faqe 2.

vitit 2003. Nga verifikimi që i kam bërë këtij momenti, pasi, me të drejtë, është vendosur në dukje edhe nga Komisioni, kontrata e shitblerjes është nënshkruar në fund të vitit 2003, ndërsa vërtetimi nga regjistri hipotekor, që pasqyron transkriptin dhe, rrjedhimisht, përmbyll procedurën e shitblerjes, është lëshuar në janar të vitit 2004. Prandaj, përpos konfuzionit në lidhje me formularin fillestar të deklarimit, kam menduar që një deklaram i saktë do të ishte ai, i cili do të përmbante të gjitha elementet e shitblerjes dhe, konkretisht, aktet formale (kontratat, regjistrimi në ZVRPP), si dhe pagesën e kryer. Meqenëse, dokumenti i regjistrimit në ZVRPP ishte akti që provonte pronësinë mbi pasurinë dhe ky akt është lëshuar në vitin 2004, atëherë edhe deklarimi i pasurisë nga unë është bërë pjesë e deklarimit në këtë vit.

Sa i takon burimit të krijimit, mosdeklarimi i tij në vitin 2004 ka ndodhur për të njëjtat shkaqe të sqaruara më sipër në pikën '1.1.1', ai nuk është bërë me qëllim. Ne, si subjekte deklarues, nuk kemi patur asnjë instruksion, as nga ILDKPKI e as nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukës, në mënyrë që të shmangej çdo pasaktësi në deklaram. Për këtë arsye, unë kam zgjedhur të deklaroj çdo pasuri timen, me aq hollësi sa kam mundur të gjykoj, për ato vite të para të deklarimit të pasurisë.

Për sa i përket krahasimit të çmimit me atë të Entit Kombëtar të Banesave, konstatimi i Komisionit për pasjen e një difference, është i drejtë, por kjo nuk mund të pasjellë asnjë penalitet në raport me pozitën time si subjekt deklarues dhe subjekt rivlerësimi, pasi: i) në lidhjen e kontratës ka konkurruar vullneti i përbashkët mes shitësit dhe blerësit sipas termave të saj, duke mos u orientuar paraprakisht në asnjë akt ligjor/nënligjor mbi këtë shitblerje.

Sikurse është shpjeguar edhe në përgjigje të Pyetëtorit nr. 3, ajo është realizuar nga shfrytëzimi i një rasti të veçantë (okazion), i ardhur si nevojë e shitësit, z. *** ***, për të shitur apartamentin e tij, përkundrajt një blerësi që i garantonte pagesë të menjëhershme në cash, pa nevojën e pritjes së procedurave mbi kredi etj.

Gjithashtu, kërkoj reduktimin e shpenzimeve të jetesës për bashkëshortin tim në masën 80%, pasi ai ka patur të siguruar ushqimin dhe veshjen, për shkak të detyrës dhe funksionit të tij [...].

15.6 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] lidhur me mosdeklarimin e pasurisë dhe burimit të krijimit të saj në DIPP-në e vitit 2004, për shkak të mungesës së eksperiencës në mënyrën se si duhet të deklaroheshin pasuritë, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi e vetërregulluar më pas, nuk mund të pasjellë penalizim për subjektin e rivlerësimit, për më tepër që nuk shoqërohet me ndonjë pamjaftueshmëri domethënëse të burimit të krijimit ...

Lidhur me konstatimin e Komisionit se çmimi i apartamentit ka rezultuar më i ulët se ai i përlllogaritur sipas çmimit të referencës të Entit Kombëtar të Banesave, trupi gjykues çmon se ky fakt nuk mund të pasjellë ndonjë penalitet në raport me pozitën e subjektit [...].

15.6.1 Në vijim, Komisioni ka reduktuar shpenzimet e jetesës për bashkëshortin në masën 50%, për periudhën 1995 – 2003, duke ndryshuar pamundësinë financiare për këtë pasuri nga -517.039 lekë, që ishte në rezultatet e hetimit, në - 187.583 lekë.

15.6.2 Komisioni ka çmuar se balanca negative, në shumën totale prej - 397.547 lekësh, shpërndahet në dy vite (2003 dhe 2007) në vlera jodomethënëse, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.

15.6.3 Në përfundim, Komisioni, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka disa pasaktësi në deklarime dhe ka mungesë të ardhurash për dy vjet, të cilat nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkaqe për shkarkimin e saj nga detyra. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

15.7 **Komisioneri Publik**, lidhur me pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 75 m², ndodhur në Tiranë*”, vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklarim të pasaktë dhe jo sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, si për sa i përket vitit të deklarimit (blerë në vitin 2003, deklaruar në vitin 2004), si dhe lidhur me deklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklarimet periodike vjetore, të cilat shërbejnë si një burim i rëndësishëm prove në procesin e rivlerësimit, parashikuar nga neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.7.1 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara nga Komisioni në shumën 517.039 lekë, pasi, sikundër është trajtuar dhe më sipër në këtë ankim, nuk paraqiti dokumentacion për të provuar të ardhurat/kompensimet e bashkëshortit të saj gjatë ushtrimit të detyrës si ushtarak, që do të ndikonin në reduktimin e shpenzimeve të jetesës për të. Gjithashtu, vërejmë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën lidhur me pamjaftueshmërinë financiare të vitit 2006, në vlerën 252.963 lekë, si rezultat i mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja e apartamentit në Tiranë për vitin 2006 dhe llogaritja e shpenzimeve të jetesës sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT²³.

15.7.2 Sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, **Komisioneri Publik** vlerëson se rezultojnë disa rrethana, të cilat duhen vlerësuar së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

16. Në përfundim, **Komisioneri Publik**, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, Vjollca Spahiu, nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke qenë në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

16.1 Në një vlerësim tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me problematikat e veprimeve të subjektit me qëllimin përfitimin e kredisë tregtare, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

17. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik

²³ Referohuni arsytimit më sipër në këtë ankim lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sip. 75 m², ndodhur në Tiranë, dhe shpenzimeve të jetesës së bashkëshortit.

ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

18. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

19. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

20. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

21. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 778, datë 28.6.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Vjollca Spahiu.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO